

REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA E TËRSHNJAKËR ANTI-KORRUPSIONI	
Procedura DPK/DMP	No. Prot. 03-4600/12
02	Data 24.12.2012

Re.l.nr.637/2012

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË DRAGASH, gjyqtari Bekri Vehapi në procedurën kundërvajtse kundër të pandehurit Shehadin Tërshnjaku nga fshati Pllavë komuna e Dragashit, për kundërvajtje sipas nenit 17 pika 1. të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollimin e pasurisë të zyrtarve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollimin e dhuratave për gjithë prsonat zyrtar, Ligji nr.04/L-050, e në bazë të nenit 73, 74 dhe neni 195 par. 1 të Ligjit mbi kundërvajtjet, me datën 17.12.2012, merrë këtë

A K T V E N D I M

SHFUQIZOHET Aktvendimi nr.637/3012, i dt.16.08.2012, si në Arsyetim.

PEZULLOHET procedura kundërvajtëse ndaj të pandehurit Shehadin Ukëshin Tërshnjaku i lindur me 01.09.1949, në fshati Pllavë komuna e Dragashit, Shqiptarë, Shtetasë i Republikës së Kosovës, Biolog i diplomuar, Nënkyretar i KK. Në Dragash, i martuar prind i 4 fëmijve, me banim të përherëshëm në vendlindje.

Në munges të provave dhe fakteve relevante për vërtetimin e fajësis, konform nenit 198.par1. pika 8. të LMK-së

A r s y e t i m

Me kërkesën e Agjencionit kundër korrupsionit të Kosovës në Prishtinë, 01-2151/2012, të dt. 04.06.2012, Gjykata për kundërvajtje me konkluzion e ka filluar procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Shehadin Tërshnjaku me të dhënat si në dispozitiv të aktvendimit.

Gjykata në bazë të procedurës për rishqyrtimin e aktvendimit të ankimuar, me dt, 20.11.2012, në seancën e shshqyrtimit verbal e ka ndegjaur të pandehurin Shehadin Tërshnjaku, i cili sipas proqesverbalit ka deklaruar se formularin e plotësuar për deklarimin e pasuris për vitin 2011, para dt. 31.03.2012, i ja kamë dorzuar personit të autorizuar kontaktues me emrin Beqir Rashiti. Ka deklaruar se nuk jam në dijeni se personi kontaktues me cilën datë formularin e plotësuar i ja ka dorzuar Agjencionit. Ka deklaruar se nuk ndihet fajtor lidhur me rrethanat e kundërvajtjes sipas kërkesës së Agjencionit. I pandehuri për vërtetimin e deklaratës së tij ka kërkuar nga gjykata që në cilësin e deshmitarit të ndëgjohe personi kontaktues Beqir Rashiti.

Deshmitari Beqir Rashiti, sipas proqesverbalit të dt.07.12.2012, ka deklaruar se unë si person i autorizuar kontaktues, zyrtarit të lartë Shehadin Tërshnjaku, formularin e zbratur për deklarimin e pasuris i ja kamë dorzuar me dt.05.03.2012. Ndërsa Shehadin Tërshnjaku formularin e plotësuar mua si person kontaktues më ka dorzuar me dt.31.03.2012. Deshmitari - pesoni kontaktues ka deklaruar se unë nuk kamë arrit që formularin e plotësuar të i ja dorzoi Agjencionit me dt.31.12.2012. Formularin e plotësuar e kamë dorzuar me vones me dt. 02.04.2012.

Gjykata ka lexuar shkresat e lëndës të Agjencionit kundër korrupsionit, deklaratën e të pandehurit, Shehadin Tërshnjaku, deklaratën e deshmitarit Beqir Rashiti dhe pikrisht nga deklarata bindëse e personit kontaktues, pa dyshim është konstatuar dhe vërtetur se i pandehuri, si zyrtar i lartë, formularin e plotësuar për deklarimin e pasuris personit kontaktues, si person i autorizuar nga KK.Dragash, i panuar edhe naga Agjencioni, e ka përmbush obligimin ligjor, në momentin e dorzimit të formularit të plotësuar me dt.

03-4600/12/02
sluz

31.03.2012, si afat i lejuar ligjor, dhe me këtë veprim është liruar nga përgjegjësija sipas ligjit 04/L-050.

Me sa u tha me lartë është vendosur si në dispozitiv të keti aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTEJE NË
DRAGASH, Me datën 17.12.2012, Re.I.nr.637/2012.

Gjyqetari për kundërvajtje,
Bekri Vehapi

KËSHILLA JURIDIKE; kundër këtij aktvendimi parashtruesi i kërkesës dhe i pandehuri kanë të drejten e ankimit në Gjykatën e lartë për kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa dërgohet me shkrim me 2.egzenplar pa taksa përmesë Gjykatës komunale për kundërvajtje në Dragash.